



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.661/20
683/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje: Z. Goran Milenković - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues dhe Z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesave të parashtuara nga grupi i operatorëve ekonomik “Botek” SHPK - Prishtinë dhe OE “Artech NTSH & Eramed NTP” - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik Aritech sh.p.k, Cimi@Elektronik sh.p.k - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore” me nr. të prokurimit 616-20-1154-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK Prishtinë më datën: 14.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHEN**, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik “Botek” SHPK –Prishtinë dhe OE “Artech NTSH & Eramed NTP”-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore” me nr. të prokurimit 616-20-1154-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK Prishtinë.

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore” me nr. të prokurimit: 616-20-1154-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK Prishtinë, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konfirmon dispozitat ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e OE “Botek” SHPK -Prishtinë dhe OE “Artech NTSH & Eramed NTP” -Prishtinë, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i’u bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues “Botek” SHPK - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP me numër 661/20 me datë 14.09.2020, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore” me nr. të prokurimit: 616-20-1154-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 28, 56 par.3, 59 dhe 108A të Ligjit për Prokurimin Publik.

Operatori ekonomik ankues “Artech NTSH & Eramed NTP” - Prishtinë ka deponuar ankesën me nr. 683/20 me datë 18.09.2020, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore” me nr. të prokurimit: 616-20-1154-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 28, 51, 52, 56 par.3, 59, 60, 69 dhe 70 të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe nenin 20, 26 par 1.2 dhe 8, nenin 28 dhe nenin 41 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 23.09.2020 dhe 01.10.2020 ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportet e dt: 23.09.2020 dhe 02.10.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues “Botek” sh.p.k -Prishtinë

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në

dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

Sa i përket pretendimit ku sipas OE ankues për Pozicionin 2. në dosjen e tenderit është kërkuar KOMPJUTER Brand Name - Mid Toëer qe ky kompjuterë të ketë; SSD- 500GB, HDD-500 GB dhe Lexuesi optik - DVD Drive, ku për këtë pozicion OE ARITECH shpk & Cimi “Electronic shpk ka dorëzuar broshurën nga Prodhuesi HP për Kompjuter HP Desktop Pro G3 ku shihet që ky Modeli i PC, i konfirmuar nga vete prodhuesi HP, nuk mundet me ofruar konfigurimin e kombinuar për Drives; SSD: 500 GB dhe HDD: 500 GB si dhe Lexuesi optik: DVD Drive, siç është kërkuar ne dosjen e tenderit, Eksperti Shqyrtues pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit dhe katalogut të ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë e gjen pretendimin si të pabazuar. OE i rekomanduar për kontratë në katalogun e tij sa i përket Kompjuterit HP Desktop Pro G3, ka të shënuara Specifikacionet për “Storage and Drives” sic edhe është prezantuar tek pjesa e fakteve në kuadër të këtij raporti. Specifikacionet e shënuara janë konform kërkesave të dosjes.

Sa i përket pretendimit ku OE ankues thotë që në dosjen e tenderit gjatë procedurës së sqarimeve shtesë te datës 13.04.2020, është qartësuar nga ana e AK- së se operatorët ekonomikë duhet te ofertojnë edhe mbajtës të TV i cili duhet t'i ketë specifikat teknike si tek pjesa e “Pretendimeve Ankimore” e këtij raporti, ku OE ankues thotë që për këtë pozicion, OE ARITECH shpk & Cimi “Electronic shpk, në ofertën e tyre NUK ka dorëzuar fare Broshurën për mbajtësin e TV si dhe NUK ka specifikuar fare modelin dhe specifikat e mbajtësit të TV, Eksperti Shqyrtues e gjen pretendimin si pjesërisht të pabazuar. Arsyeimi është si në vijim:

- Kërkesa e Autoritetit Kontraktues në FDT sa i përket kapacitetit teknik dhe profesional të OE pjesëmarrës është shënuar që decidivisht “Operatorët Ekonomik duhet të sjellin katalogun për produktet teknologjike”. Duke marrë parasysh që mbajtësja e TV nuk konsiderohet produkt teknologjik, Operatorët ekonomikë nuk mund të shpallen të përgjegjshëm për kritere të cilat nuk janë të specifikuara në FDT. Një interpretim i tillë është po ashtu i bazuar në “parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP-së”, ku konform RRUOPP, gjegjësisht nenit 41.3 “Vetëm kërkesat dhe kritere e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdorën si bazë për vlerësim”.

Sa i përket pretendimit ku thuhet që OE ARITECH shpk & Cimi “Electronic shpk në ofertën e tyre nuk ka dorëzuar fare Broshurën për Keyboard e TV si dhe nuk ka specifikuar fare modelin dhe specifikat e Keyboardit për TV, Eksperti Shqyrtues pas rishikimit të dokumentacionit e gjen pretendimin si të bazuar. Katalogu për TV nga OE i rekomanduar për kontratë nuk përfshin edhe Keyboard, ku në paramasë është e shënuar si e domosdoshme, përkundër që çmimi i produktit TV është që të shënohet si në total (me të gjitha pjesët përcjellëse të tij). Sidoqoftë, mbetet në diskrecion të Autoritetit Kontraktues që vlefshmëria e dokumentacionit/katalogut të prezantuar si jo i plotë të trajtohet konform nenit 72 – “Kur informacioni apo

dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor”.

Sa i përket pretendimit ku sipas OE ankues “Iso Certifikata 9001:2015” e dorëzuar nga OE “Cimi@Electronic shpk” rezulton qartësisht se ka pas Validitet vetëm deri me 01.07.2020 dhe jo sikurse është kërkuar “me validitet për vitin 2020- 2021“ si dhe Maili i dt. 02.06.2020 nga Kompania Certifikuese i dorëzuar me ofertën e këtij grupi, Eksperti jep këtë mendim si në vijim:

- Iso Certifikata 9001:2015 dorëzuar nga OE “Cimi@Electronic shpk” ka pasur validitet deri më 01.07.2020, datë kjo valide në kohën e shpalljes së OE të lartpërmendur si fitues. Kërkesa e Autoritetit Kontraktues që një certifikatë e tillë të ketë validitetin e shtruar në dy vite, 2020 & 2021, nuk i pamundëson OE të lartpërmendur që të zgjatë validitetin e ISO Certifikatës konform procesit të nisur, atij të auditimit sic është edhe konfirmuar nga Trupa e Certifikimit (shih faktin 3). Një gjë e tillë plotësohet duke marrë parasysh edhe interpretimin e mëposhtëm.
- Mungesa e Certifikatës Iso mund të plotësohet edhe konform dispozitave ligjore të shënuara në RRUOPP, gjegjësisht nenit 69.

Mungon certifikata ISO	Mund të kërkojnë informata sqaruese	69
------------------------	-------------------------------------	----


Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë dhe natyrën e pretendimeve, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e operatorit ekonomik ankues si pjesërisht të bazuar, duke sugjeruar kështu që njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore” me nr. të prokurimit: “616-20-1154-1-1-1”, *aktivitet ky i iniciuar nga AK: KK Prishtinë*, të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e grupit të OE ankues duhet të jetë: pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues OE “Artech NTSH & Eramed NTP” –Prishtinë

Sa i përket pretendimit të AK-së se Certifikata ISO Standard 9001:2015 e dorëzuar nga anëtari i grupit OE ankues nuk është në përputhje me kërkesat e paraqitura në FDT dhe nuk përkon me fushëveprimin e tenderit në fjalë, Eksperti Shqyrtues pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit, analizës dhe hulumtimit të pavarur e gjen pretendimin e AK-së si të pabazuar. Arsyetimi vijon si më tutje:

- Kërkesa e Autoritetit Kontraktues është që “Operatorët Ekonomik duhet të kenë Certifikatën ISO Standardeve 9001-2015 me validitet për vitin 2020-2021”. Do të thotë, AK nuk ka specifikuar fushëveprim të Certifikatës në FDT, dhe nuk mund të përdorë kritere të cilat nuk janë të specifikuara në Dosje për vlerësim të Operatorëve. Një interpretim i tillë është po ashtu i bazuar në “parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP-së”, ku konform RRUOPP, gjegjësisht nenit 41.3 “Vetëm kërkesat dhe kritere e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdorën si bazë për vlerësim”.
- Për nga përmbajtja, standardi ISO 9001: 2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë të një organizate. Do të thotë, të gjitha kërkesat si parakushte të standardit ISO 9001: 2015 janë gjenerike dhe synojnë të zbatohen për çdo organizatë, pavarësisht nga lloji ose madhësia e saj, ose produktet dhe shërbimet që ofron. Një informacion i tillë mund të gjendet edhe në ëbfaqen zyrtare të ISO-s (shih foton më poshtë).



Sa i përket pretendimit të AK-së ku thuhet që katalogu i prezantuar është modifikuar dhe falsifikuar dhe se laptop-i i markës ACER ASPIRE 3 me numër të produktit (A315-54K-361G) nuk mund të gjendet në ëbfaqen zyrtare të kompanisë, Eksperti Shqyrtues e gjen pretendimin si të pabazuar. Arsyetimi është si në vijim:

- Katalogu për ACER Aspire 3 me numrin e produktit të lartpërmendur është konfirmuar që të jetë relevant dhe konform specifikacioneve të produktit të ofertuar edhe nga prodhuesi (shih faktin me numër 3). Një letër të tillë konfirmimi kanë marrë edhe Autoriteti Kontraktues me datë 01.09.2020. Si i tillë, është dashur të konsiderohet nga AK-ja përkundër mos-gjetjes së katalogut në ëbfaqen e prodhuesit për konfirmim.

- Mbetet në diskrecion të Autoritetit Kontraktues që vlefshmëria e dokumentacionit/katalogut të prezantuar si jo i plotë të trajtohet konform nenit 72 – “Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor”.

Sa i përket pretendimit ku sipas OE ankues “*Iso Certifikata 9001:2015* “ e dorëzuar nga OE të rekomanduar për kontratë rezulton se ka pas Validitet vetëm deri me 01.07.2020 dhe jo sikurse është kërkuar “me validitet për vitin 2020- 2021“ si dhe Maili i dt. 02.06.2020 nga Kompania Certifikuese i dorëzuar me ofertën e këtij grupi, Eksperti e konsideron pretendimin si çështje tashmë të gjykuar në raportin e mëparshëm të ankesës me numër 661/20.

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë dhe natyrën e pretendimeve, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e operatorit ekonomik ankues si të bazuar, duke sugjeruar kështu që njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore” me nr. të prokurimit: “616-20-1154-1-1-1”, *aktivitet ky i iniciuar nga AK: KK Prishtinë*, të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e grupit të OE ankues duhet të jetë: e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues me datën 07.10.2020, me anë të parashtresës e ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik “Botek” SHPK –Prishtinë, me datën 25.09.2020 me anë të parashtresës e ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Sqarime shtese nga OE “Botek”SHPK -Prishtinë

Per Panelin shqyrtues të lëndës & Ekspertin Shqyrtues

Për Aktivitetin e Prokurimit: “Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore”

Nr. i Prokurimit: 616-20-1154-1-1-1

Prishtinë, 25. Shtator 2020

Të nderuar anëtar të panelit shqyrtues të OSHP-së,

I nderuari z. Dior Halili, Ekspert Shqyrtues,

Ne konstatojmë me keqardhje se në këtë Ekspertizë janë bërë lëshime teknike /keqinterpretime teknike, të cilat nuk do donim të kishin ndodhur dhe në fakt nuk do duhej të ndodhnin.

Në vijim po i Ri konfirmojmë / sqarojmë pikat të cilat eksperti shqyrtues për mungesë të ekspertizës teknike edhe mund t'i kenë ikur pa i vërejtur apo nuk ka arritur t'i interpretoj teknikisht me saktësi.

PIKA 1. Sqarim: Për pozicionin 2 KOMPJUTER Brand Name -Mid Toëer, Në DT është kërkuar që kjo pajisje të ofrohet me 3x komponentë – për 2X Storage and 1x Drives (SSD, HDD dhe Lexuesi Optik).

Ndërsa për këtë pozicion OE Aritech & Cimi@Electronic shpk kanë ofertuar Pajisjen HP Desktop Pro 300 G3 e cila nuk ka mundësi nga vetë prodhuesi të ofrohet me 3x komponente për Storage and Drives siç është kërkuar në DT por kjo pajisje ka mundësi të ofrohet vetëm me 2x komponente për Storage and Drives ku klienti mund të zgjedhë sipas nevojës se cilat komponentë mund të kombinoj.

Në ekspertizën tuaj ju nuk e keni marr për bazë fare faktin apo e keni keqkuptuar që kjo pajisje kërkohet të ofrohet me 3x komponentë, (pra 2X Storage and 1X Drives) dhe nuk i keni marr për bazë fare faktet që kjo pajisje nga prodhuesi HP ofrohet vetëm me 2x komponente .

Pra, për sa i përket pretendimit tonë se Modeli I Pajisjes HP (Kompjuter HP Desktop Pro G3) i ofertuar nga OE Aritech & Cimi@Electronic shpk, duke u bazuar në Broshurat e prodhuesit, NUK ka mundësi konfigurimi sikurse është kërkuar kombinim i 3X komponente për storage and drives: SSD,HDD dhe Lexuesi Optik dhe këtu s'ka asnjë dilemë pasi që qartësisht dhe përtej çfarëdo keqinterpretimi po në këtë broshurë shkruan qartë:

Prova 1: Për ta vërtetuar këtë fakt, ju lutem e gjeni te bashkangjitur broshurën e dorëzuar nga vete OE, “Broshurat - Pjesa 2 - PC dhe Monitor” konkretisht në faqen 2 të broshurës ku shkruan qartësisht “KUJDES” si në vijim se kjo Pajisje lejon/suporton vetëm këto kombinime:

Note: Following configurations are supported:

- a) 3.5" internal storage & 9.5mm optical drive
- b) 2.5" internal storage & 9.5mm optical drive
- c) 3.5" internal storage & 2.5" internal storage
- d) 2.5" internal storage & 2.5" internal storage**

Pra ne nuk kemi interpretua asgjë por e lusim ekspertin shqyrtues duke konsultuar edhe persona teknik si dhe dokumentacionin e tenderit ta Rishikoj me kujdes Interpretimin e tij pasi që këtu s'ka asnjë dilemë dhe se vet Prodhuesi thërret në “Note” dhe këtë PROVË e cila gjendet në Broshurën e prodhuesit HP të cilën

Broshurë këta OE e kanë dorëzuar me tender. Rrjedhimisht, përtej çfarëdo dileme kjo pajisje e ofertuar, NUK ipërmbushë kërkesën teknike sipas dosjes së tenderit.

PIKA 2. Ne shprehim mospajtimin tonë me konstatimin e Ekspertit se “Sqarimet shitesë NUK qenkan bazë për Vlerësim e tenderit”.

Ne besojmë se OSHP do ta qartëson përtej çfarëdo dileme se sqarimet shitesë janë pjesë përbërëse e tenderit dhe sikurse OE që i marrin parasysh gjatë përgatitjes së Ofertës ashtu edhe AK gjatë vlerësimit është i obliguar t’i marr për bazë.

Pra, duke i marr për bazë sqarimet shitesë, OE Aritech & Cimi@Electronic shpk, me ofertën e tyre NUK i kanë përmbushë kërkesat e AK të cilët kanë të bëjnë me mosdorëzimin e Ofertën teknike dhe Broshurës ku është kërkuar të saktësohet modelin dhe karakteristikat tjera të mbajtësit të TV.

Prandaj e ftojme Ekspertin e lëndës t’i merr për bazë sqarimet shitesë nga AK dhe të Rivlerësoj këtë pikë duke përmirësuar edhe mendimin e dhënë në këtë Ekspertizë.

Sa për t’i rikujtuar edhe Ekspertit, në RUOPP decidivisht sanksionon:

Problemi	Si të veprohet	Neni i LPP-së
Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu	Refuzo tenderin pa kërkuar informata të mëtutjeshme	28

PIKA 3. Përkundër faktit se Eksperti Shqyrtues pajtohet me pretendimin tonë dhe Ri konfirmon se OE Aritech & Cimi@Electronic shpk, “NUK ka dorëzuar fare Broshuren për Keyboard të TV si dhe Nuk ka specifikuar fare Modelin dhe specifikat e Keyboardit per TV” .

Duke u mbështet në RRUOPP, AK në këtë rast automatikisht do duhej ta Refuzonte ofertën e këtij OE si të papërgjegjshme.

Pra, RUOPP, decidivisht sanksionon:

Problemi	Si të veprohet	Neni i LPP-së
Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu	Refuzo tenderin pa kërkuar informata të mëtutjeshme	28

PIKA 4. Ne Nuk pajtohemi gjithashtu me Konstatimin e Ekspertit për sa i përket Validitetit të ISO Certifikatës.

Kërkesa ne Dosjen e Tenderit ka qenë ashtu sikurse e konfirmon edhe Eksperti: OE duhet të dorëzojnë ISO Certifikatën me Validitet për vitin 2020-2021. Ky EO kanë dorëzuar Certifikatë me Validitet deri me 01. 07. 2020.

Pra, këtu NUK vlen Dispozita e RRUOPP gjegjësisht Neni 69 pasi që ky OE ka dorëzuar Certifikatën POR e njëjta NUK përmbushë kërkesën e AK pasi që NUK ka Validitetin e kërkuar sipas FDT dhe rrjedhimisht NUK mund të Kërkohen Informata sqaruese dhe të shtohet asnjë Dokument shtesë për ta plotësuar këtë pikë. Edhe njëherë lusim ekspertin ta interpretoj saktë piken 59 të RRUOPP ku theksohet qartësisht se vetëm nëse “MUNGON Certifikata ISO” - “Mund të kërkohen informata sqaruese”, por JO atëherë kur OE dorëzon Certifikatë JO Valide.

Me respekt,

Operatori Ekonomik “Artech NTSH & Eramed NTP” -Prishtinë , me datën 05.10.2020 me anë të parashtrësës e ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 14.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Botek” sh.p.k –Prishtinë, se në pozicionin 2 të dosjes së tenderit është kërkuar kompjuter Brand Name - Mid Toëer që ky kompjuterë të ketë: SSD- 500GB, HDD-500 GB dhe Lexuesi optik - DVD Drive, ku për këtë pozicion OE ARITECH shpk & Cimi “Electronic shpk ka dorëzuar broshurën nga prodhuesi HP për kompjuter HP Desktop Pro G3, ku shihet që ky Modeli i PC, i konfirmuar nga vete prodhuesi HP nuk mundet me ofruar konfigurimin e kombinuar për Drives: SSD: 500 GB dhe HDD: 500 GB, si dhe lexuesi optik: DVD Drive, siç është kërkuar ne dosjen e tenderit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit dhe katalogut të ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë, e gjen pretendimin si të pa bazuar. OE i rekomanduar për kontratë në katalogun e tij sa i përket kompjuterit HP Desktop Pro G3, ka të shënuara Specifikacionet për “Storage and Drives” siç edhe është prezantuar tek pjesa e fakteve në kuadër të këtij raporti. Specifikacionet e shënuara janë konform kërkesave të dosjes.

Sa i përket pretendimit të OE ankues “Botek” sh.p.k –Prishtinë, se në dosjen e tenderit gjatë procedurës së sqarimeve shtesë te datës 13.04.2020, është qartësuar nga ana e AK-së se operatorët ekonomikë duhet të ofertojnë edhe mbajtës të TV i cili duhet t'i ketë specifikat teknike si tek pjesa e “Pretendimeve Ankimore” e këtij raporti, ku OE ankues thotë që për këtë pozicion, OE ARITECH shpk & Cimi “Electronic shpk në ofertën e tyre nuk ka dorëzuar fare broshurën për mbajtësin e TV si dhe nuk ka specifikuar fare modelin dhe

specifikat e mbajtësit të TV, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim është pjesërisht i pa bazuar për shkak se kërkesa e AK-së në FDT sa i përket kapacitetit teknik dhe profesional të OE pjesëmarrës është shënuar që decidivisht “Operatorët Ekonomik duhet të sjellin katalogun për produktet teknologjike”. Duke marrë parasysh që mbajtësja e TV nuk konsiderohet produkt teknologjik, operatorët ekonomikë nuk mund të shpallen të papërgjegjshëm për kritere të cilat nuk janë të specifikuara në FDT. Një interpretim i tillë është po ashtu i bazuar në “parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP-së”, ku konform RRUOPP, gjegjësisht nenit 41.3 “Vetëm kërkesat dhe kritere e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdorën si bazë për vlerësim”.

Ndërsa, sa i përket pretendimit të OE ankues “Botek” sh.p.k –Prishtinë, ku thuhet që OE ARITECH shpk & Cimi “Electronic shpk në ofertën e tyre nuk ka dorëzuar fare broshurën për Keyboard e TV, si dhe nuk ka specifikuar fare modelin dhe specifikat e Keyboardit për TV, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas rishikimit të dokumentacionit e gjen pretendimin si të bazuar. Katalogu për TV nga OE i rekomanduar për kontratë nuk përfshin edhe Keyboard, ku në paramasë është e shënuar si e domosdoshme, përkundër që çmimi i produktit TV është që të shënohet si në total (me të gjitha pjesët përcjellëse të tij). Sidoqoftë, mbetet në diskrecion të Autoritetit Kontraktues që vlefshmëria e dokumentacionit/katalogut të prezantuar si jo i plotë të trajtohet konform nenit 72 – “Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor”.

Kurse, lidhur me pretendimin e OE ankues “Botek” sh.p.k –Prishtinë, se “*Iso Certifikata 9001:2015*” e dorëzuar nga OE “Cimi@Electronic shpk” rezulton qartësisht se ka pas Validitet vetëm deri me 01.07.2020 dhe jo sikurse është kërkuar “me validitet për vitin 2020- 2021” si dhe Maili i dt. 02.06.2020 nga kompania certifikuese i dorëzuar me ofertën e këtij grupi, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se Iso Certifikata 9001:2015 dorëzuar nga OE “Cimi@Electronic shpk” ka pasur validitet deri më 01.07.2020, datë kjo valide në kohën e shpalljes së OE të lartpërmendur si fitues. Kërkesa e Autoritetit Kontraktues që një certifikatë e tillë të ketë validitetin e shtruar në dy vite, 2020 & 2021 nuk i pamundëson OE të lartpërmendur që të zgjatë validitetin e ISO Certifikatës konform procesit të nisur, atij të auditimit siç është edhe konfirmuar nga trupa e certifikimit. Një gjë e tillë plotësohet duke marrë parasysh se mungesa e certifikatës Iso mund të plotësohet edhe konform dispozitave ligjore të shënuara në RRUOPP, gjegjësisht nenit 69.

Mungon certifikata ISO	Mund të kërkojnë informata sqaruese	69	
------------------------	-------------------------------------	----	--

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Artech NTSH & Eramed NTP” –Prishtinë, se certifikata ISO Standard 9001:2015 e dorëzuar nga anëtari i grupit OE ankues nuk është në përputhje me kërkesat e paraqitura në FDT dhe nuk përkon me fushëveprimin e tenderit në fjalë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesa e autoritetit kontraktues është që “Operatorët Ekonomik duhet të kenë Certifikatën ISO Standardeve 9001-2015 me validitet për vitin 2020-2021”. Do të thotë, AK nuk ka specifikuar fushëveprim të Certifikatës në FDT, dhe nuk mund të përdorë kritere të cilat nuk janë të specifikuara në dosje për vlerësim të operatorëve. Një interpretim i tillë është po ashtu i bazuar në “parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP-së”, ku konform RRUOPP, gjegjësisht nenit 41.3 “Vetëm kërkesat dhe kritere e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdoren si bazë për vlerësim”. Po ashtu, për nga përmbajtja, standardi ISO 9001: 2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë të një organizate. Do të thotë, të gjitha kërkesat si parakushte të standardit ISO 9001: 2015 janë gjenerike dhe synojnë të zbatohen për çdo organizatë, pavarësisht nga lloji ose madhësia e saj ose produktet dhe shërbimet që ofron. Një informacion i tillë mund të gjendet edhe në ëbfaqen zyrtare të ISO-s, ku eksperti i ka bashkangjitur raportit.

Sa i përket pretendimit të AK-së, ku thuhet që katalogu i prezantuar është modifikuar dhe falsifikuar dhe se laptop-i i markës ACER ASPIRE 3 me numër të produktit (A315-54K-361G) nuk mund të gjendet në ëbfaqen zyrtare të kompanisë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimi i AK-së është i pa bazuar për shkak se katalogu për ACER Aspire 3 me numrin e produktit të lartpërmendur është konfirmuar që të jetë relevant dhe konform specifikacioneve të produktit të ofertuar edhe nga prodhuesi (shih faktin me numër 3). Një letër të tillë konfirmimi kanë marrë edhe autoriteti kontraktues me datë 01.09.2020. Si i tillë, është dashur të konsiderohet nga AK-ja përkundër mos-gjetjes së katalogut në ëbfaqen e prodhuesit për konfirmim. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se mbetet në diskrecion të autoritetit kontraktues që vlefshmëria e dokumentacionit/katalogut të prezantuar si jo i plotë të trajtohet konform nenit 72 – “Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor”.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Artech NTSH & Eramed NTP” –Prishtinë, se “*Iso Certifikata 9001:2015*” e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë rezulton se ka pas Validitet vetëm deri me 01.07.2020 dhe jo sikurse është kërkuar “me validitet për vitin 2020- 2021” si dhe Maili i dt. 02.06.2020 nga kompania certifikuese i dorëzuar me ofertën e këtij grupi, Paneli Shqyrtues sqaron se Iso Certifikata

9001:2015 dorëzuar nga OE “Cimi@Electronic shpk” ka pasur validitet deri më 01.07.2020, datë kjo valide në kohën e shpalljes së OE të lartpërmendur si fitues. Kërkesa e Autoritetit Kontraktues që një certifikatë e tillë të ketë validitetin e shtruar në dy vite, 2020 & 2021 nuk i pamundëson OE të lartpërmendur që të zgjatë validitetin e ISO Certifikatës konform procesit të nisur, atij të auditimit siç është edhe konfirmuar nga trupa e certifikimit. Një gjë e tillë plotësohet duke marrë parasysh se mungesa e certifikatës Iso mund të plotësohet edhe konform dispozitave ligjore të shënuara në RRUOPP, gjegjësisht nenit 69.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform kërkesave të dosjes së tenderit, si dhe konform nenit 59 të LPP-së. Andaj, obligohet autoriteti kontraktues që të bëjë vlerësimin e ofertave duke u bazuar në kriteret e dosjes së tenderit dhe të kërkojë sqarime shtesë nga operatorët ekonomik konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së lidhur me pretendimet e kontestuar.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Kuvendi Komunal i Prishtinës;
- 1x1 OE “Botek” SHPK –Prishtinë;
- 1x1 OE “Artech NTSH & Eramed NTP” -Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.